



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I BASHKISË KORÇË

V E N D I M

Nr. 15 datë 29 . 1 2026

**“PËR MIRATIMIN E PROJEKTIT TË “STIMULIMI I INDUSTRIVE KREATIVE” DHE PËRZGJEDHJEN E PARTNERIT PËR ZBATIMIN E KËTIJ PROJEKTI NË QYTETIN E KORÇËS”**

Drejtorja e Financës, Buxhetit dhe MFK; Drejtorja e Përgjithshme Juridike dhe e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, Drejtorja e Turizmit, Projekteve të Zhvillimit, bazuar në nenin 25 të ligjit Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, referuar nenit 54 «Detyrat dhe kompetencat e Këshillit bashkiak» VKB NR. 139 datë 26.12.2025 “ Për projekt buxhetin e Bashkisë Korçë i vitit 2026 dhe PBA 2026- 2028” ligji Nr. 70/2016 “Për Zejtarinë në Republikën e Shqipërisë” dhe mbas diskutimeve të këshilltarëve, ligji nr. Nr. 43/2022 “Për Zhvillimin e ndërrmarjeve mikro, të vogla dhe të mesme” ,

KËSHILLI BASHKIAK

V E N D O S I

1. Të miratojë projektin e “*Stimulimi i Industrive Kreative*” në qytetin e Korçës.
2. Të autorizojë Kryetarin e Bashkisë Korçë të kryejë procedurat e konkursit dhe të përzgjedhjes së ambinateve ku do të ushtrohet aktiviteti i artizanëve dhe prodhuesve kreative lokale dhe nënshkrimin e kontratave të qirasë.
3. Të autorizojë Kryetarin e Bashkisë Korçë të kryejë procedurën e përzgjedhjes të shoqërisë që do të zbatojë projektin “*Stimulimi i Industrive Kreative*” me të cilin Bashkia Korçë do të bashkëpunojë për realizimin e projektit dhe nënshkrimin e marrëveshjeve me këtë subjekt.
4. Kontratat e qirase për zhvillimin e aktivitetit të artizanëve dhe prodhuesve kreative lokale do të lidhen për një periudhë 1 (një) vjeçare.
5. Marrëveshja me shoqërinë që do të përzgjidhet për realizimin e projektit do të lidhet për një periudhë 3 (tre) vjeçare.
6. Ambientet ku do të zhvillohet aktiviteti i artizanëve dhe prodhuesve kreative lokale do të jetë në Pazarin e Vjetër Korçë.
7. Kriteret për përzgjedhjet e shoqërisë së artizanëve do të jenë si më poshtë:

KRITERET LIGJORE (10 pikë)

Subjekti aplikues duhet:

- Të jetë person juridik (shoqëria) i regjistruar sipas legjislacionit shqiptar në fuqi (provuar me vendim gjykatë/dokument tjetër lëshuar sipas kërkesave të ligjit nga institucionet përkatëse);
- Të ketë përvojë të dokumentuar në zbatimin e projekteve për zhvillimin ekonomik lokal;

- Te krijoje mundesi per vetepunesim dhe siper marrje te vogel;
- Të ketë objekt veprimtarie të lidhur me artizanatin /zejtarine ose fusha të ngjashme;
- Të mos ketë detyrime tatimore, taksa, tarifa vendore dhe detyrime të prapambetura; (vertetime nga andimistrata tatimore dhe bashkia);
- Të mos jetë në proces falimentimi apo likuidimi.(vertetim nga gjykata);
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë (çertifikatë e gjëndjes gjyqësore/ose e ngjashme)

KRITERI PROFESIONAL (10 pikë)

Subjekti duhet:

- Të provojë eksperiencë të mëparshme në ofrimin e shërbimeve artizanale (kontrata të mëparshme);
- Të disponojë staf të kualifikuar, me njohuri të gjuhëve të huaja dhe të trashëgimisë artizanale (diplome, listpagesa. cv);
- Të paraqesë një plan të detajuar të organizimit dhe funksionimit të projektit të **“Stimulimi i Industrive Kreative**, mënyrës si do asistojë dhe do promovojë produktin vendas në panairë të ndryshme lokale kombëtare dhe pjesëmarrjen në konferenca të ndryshme në favor të tregut në fushën e artizanëve/zejtarëve;
- Të ketë minimum 5 vite eksperiencë në fushën e artizanatit/zejtarisë dhe prodhuesve kreative lokale.

KAPACITETI FINANCIAR (10 pikë)

Subjekti aplikues duhet:

- Të demonstrojë kapacitet financiar për realizimin e shërbimit (Projekti që do të zbatohet në ofrimin e këtij shërbimi);
- Aftësi për të menaxhuar fonde dhe projekte
- Aftësi për të siguruar të ardhura shtesë (projekte donacione, partneritete) të qëndrueshme.

8. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe MFK; Drejtoria e Përgjithshme Juridike dhe e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore si dhe Drejtoria e Turizmit, Projekteve të Zhvillimit.

9. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike.

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Eva NAÇI

Miratuar me 21 vota  
 Vota Pro 21  
 Vota Kundër 1  
 Vota Abstenim 2  
 Zbardhur më datë 29-1-2026

